

Raporti vjetor i punës

PËRMBAJTJE

I. Përmbledhje ekzekutive.....	2
II. Monitorimi në Komunën e Prizrenit.....	3
III. Aktivitetet e Forumit Transparenca.....	4
IV. Ndikimi i projektit.....	11
V. Falënderim.....	13

Sekretariati i Forumit Transparenca
EC Ma Ndryshe

OJQ EC Ma Ndryshe ~ Saraqët, Nr. 5 – Prizren ~ Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B 1, Nr. 5 – Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~038 244 967 & 029 222 771

I. Përmbledhje ekzekutive

Raporti i titulluar “Një vit bashkë për qeverisje transparente” përfshin punën njëvjeçare të Forumit Transparenca, i përbërë nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarëve të Prizrenit.

Në mars të vitit 2014, EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit “Transparenca online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës” ka iniciuar idenë për themelimin e Forumit Transparenca. Pas një procesi të konsultimeve ndërmjet pjesëtarëve të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të medieve, që ka zgjatur për disa javë dhe në përpjekje të gjetjes së formave për rritjen e transparencës institucionale, në Prizren është themeluar Platforma e përbashkët e veprimit të aktivistëve të shoqërisë civile dhe medias, e titulluar në mënyrë simbolike “Forumi Transparenca”.

Kjo platformë synon që të koordinojë dhe promovojë veprimet e aktivistëve të shoqërisë civile dhe gazetarëve që janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike, të rrisë vizibilitetin e punës së shoqërisë civile përmes prezencës së shtuar në mediat lokale dhe qendrore, pastaj të ngre aftësinë avokuese të shoqërisë civile për qeverisje më transparente dhe llogaridhënese në Prizren, si dhe të ngre pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje dhe të sigurojë që kërkesat e tyre merren parasysh.

Ky trup joformal përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit, të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike dhe misioni i tij është koordinimi i veprimeve të këtyre akterëve për të rritur nivelin e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes lokale të Prizrenit.

Pas konsultave të brendshme është arritur pajtimi që veprimet konkrete të kësaj platforme fillimisht të përfshijnë avokimin për miratimin

dhe zbatimin e Planit të Veprimit për Transparenca në komunë, monitorimin e praktikave në hartimin, miratimin dhe shpenzimin e buxhetit komunal me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare, pastaj monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe dokumenteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës, ndërkohë që janë organizuar dhe forume publike të diskutimit mbi çështjet e qeverisjes demokratike dhe çështje të tjera.

Forumi Transparenca gjatë tërë vitit bazuar në dispozitat ligjore që përkufizojnë të drejtën në qasje në dokumente publike dhe të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje ka përcjellë, hulumtuar dhe raportuar për vendimet dhe dukuritë që nuk janë në përputhje me ligjin apo obligimet morale të qeverisjes së mirë. Gjatë një viti ky Forum këto të gjetura i ka adresuar në publik përmes komunikatave dhe debateve.

Brenda periudhës 12 mujore Forumi Transparenca përmes debateve “Ballafaqim” ka trajtuar dhe ngritur për opinionin tematika të ndryshme nga aktualiteti i qeverisjes lokale sikurse defektet në transparencë, urbanizëm, inspektorat, në arsim, prokurim, shërbime publike, kulturë, siguri, financa dhe buxhet, investimet jo të qëlluara.

Ajo që vlen të theksohet është se përkundër një numri të madh të komunikatave dhe debateve rreth këtyre çështjeve, ku janë përpiluar rekomandime konkrete, qeveria lokale ka treguar pak vullnet për zbatimin e këtyre rekomandimeve rrjedhimisht dhe përmirësimin e defekteve të argumentuara nga shoqëria civile dhe gazetarët.

Megjithëkëtë Forumi Transparenca ka prodhuar edhe rezultate pozitive. Gjatë kësaj kohe, pas kërkesave dhe insistimit të Forumit kryetari i

Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja lejoi pjesëmarrjen e publikut, shoqërisë civile dhe gazetarëve në përcjelljen dhe monitorimin e mbledhjeve dy javore të ekzekutivit sikurse edhe raportimin e vendimeve të dala nga këto takime, paralelisht edhe konferencat për media pas çdo takimi.

Gjithashtu autoritetet komunale kanë rritur nivelin e përgjegjësisë sa i përket ofrimit të vendimeve të lidhshmeve komunal.

Gjatë kësaj periudhe kohore është ndjerë një klimë pozitive e zyrtarëve komunal, karshi Forumit Transparenca, me vetë gatishmërinë e tyre për tu ballafaquar me temat e aktualitetit të ngritur nga anëtarët e Forumit Transparenca, të cilat janë debatuar edhe me praninë e përfaqësuesve të partive politike opozitare dhe grupeve të interesit.

Fillimisht, sekretariatit e Forumit Transparenca është duke e udhëhequr OJQ EC Ma Ndryshe, dhe kjo do të pasojë me rotacion.

II. Monitorimi në Komunën e Prizrenit

OJQ “EC Ma Ndryshe”, në kuadër të projektit Transparenca online... monitoronte takimet e ekzekutivit komunal të Prizrenit dhe raportonte mbi vendimet e marra përmes njoftimeve për shtyp.

Mirëpo kjo praktikë nuk mjaftonte për përmbushjen e nevojave të publikut për informim, prandaj në konsulta me gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile është marrë nisma që nga qeveria komunale të kërkohet hapja e takimeve të kryetarit Muja me drejtorët e tij.

Pas insistimit të Forumit Transparenca qeveria lokale ka hapur për publikun takimet e saja, në atë mënyrë që krahas aktivistëve të shoqërisë civile të pranishëm janë edhe gazetarët, të cilët raportojnë vazhdimisht mbi vendimet e marra dhe diskutimet e zhvilluara.

II. Aktivitetet e Forumit Transparenca

Gjatë kësaj periudhe kohore, Forumi Transparenca ka organizuar dhjetë debate të quajtura “Ballafaqim”, me zyrtarët e Komunës së Prizrenit dhe institucionet tjera publike, ku janë trajtuar çështje të ndryshme aktuale, në interes të publikut. Krahas debateve është mbajtur edhe një tryezë e gjerë diskutimi, derisa qëndrimet rreth çështjeve aktuale janë shprehur edhe përmes komunikatave dhe reagimeve.

i) Debatet “Ballafaqim”

-Punësimet në Arsim

Më 14 maj 2014, Forumi Transparenca, ka organizuar debatin e parë të ciklit “Ballafaqim” mbi punësimet në arsim. Në moderimin e gazetarit Qazim Thaqi, drejtori i arsimit në Prizren Nexhat Çoçaj është përballur me pyetje të shumta nga përfaqësuesit e Forumit Transparenca, përfaqësuesi nga Vetëvendosje dhe nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit në Prizren.

Diskutimet janë zhvilluar rreth punësimeve në arsim, emërimit të drejtorëve të ri nëpër shkollat e komunës së Prizrenit, infrastrukturës në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke vazhduar me sigurinë në shkolla, punësimet politike, kushtëzimin e nxënësve nëpër shkolla,

punësimin e zyrtarëve të lartë komunal në arsim, cilësia në mësimdhënie, obligimet e nxënësve për kurse shtesë, përfshirja në listë të pagave të disa mësimdhënësve, etj.

-Trajtimi i ndërtimeve pa leje

Debati i dytë i ciklit “Ballafaqim” është mbajtur më 16 qershor 2014, me temën: “Trajtimi i ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit”. Debati i dytë ka trajtuar çështjet e infrastrukturës ligjore lokale për sa i përket ndërtimeve në këtë zonë, kompetencat dhe koordinimin e brendshëm të Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtorisë së Inspektoratit, procedurës rreth lejeve të ndërtimit, inspektimit të tyre si dhe sfidat e institucioneve karshi ndërtuesve.

Gjatë debatit u trajtuan pyetje të shumta për sa i përket ndërtimeve në zonën e parë dhe më gjerë, mbrojtja e objekteve të vjetra, kostoja në intervenimin e rrëtimeve, etj. Panelistë të debatit ishin: Nijazi Kryeziu dhe Bedri Bytyqi dhe është moderuar nga gazetari Rami Berisha, anëtar i Forumit Transparenca.

- Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren

Më 3 korrik 2015, Forumi Transparenca ka mbajtur debatin e tretë të ciklit “Ballafaqim” me temë: “Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren”, ku folën Ymer Berisha, zyrtar për informim i Komunës dhe Kujtim Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës. Panelistët kishin një përballje me anëtarët e Forumit Transparenca dhe përfaqësuesit e partive politike opozitare në Prizren, ndërsa debati u moderua nga gazetarja e Radio Kosovës, Valbona Musliu, anëtare e Forumit Transparenca.

Diskutimi u fokusua në çështjet e transparencës dhe llogaridhënies së komunës së Prizrenit. Në

mënyrë të veçantë u trajtuan problemet në raport me informimin publik, konsultimet publike, transparencën financiare, takimet e ekzekutivit si dhe qasjen në dokumente publike. Hapja e vendimmarrjes së ekzekutivit ndaj mediave dhe organizatave të shoqërisë civile u rikonfirmua si njëra ndër kërkesat më esenciale të Forumit Transparenca. Për më tepër, pjesëmarrësit e diskutimit konstatuan ngecje të transparencës dhe llogaridhënies në raport me përditësimin e ueb-faqes së komunës, publikimin e procesverbaleve të Kuvendit, përpilimin e raporteve të punës së Kuvendit dhe përfshirjen e qytetarëve në marrjen e vendimeve.

Gjatë debatit, zyrtarët e komunës kanë insistuar se komuna e Prizrenit tregon nivel të lartë të transparencës, ndërsa kanë shfaqur prire për të shpërndarë përgjegjësinë tek zyrtarë individual në rastet e cenimit të transparencës. Përfaqësuesit e partive politike opozitare kanë qenë shumë kritike ndaj punës së organeve komunale, e sidomos ndaj ekzekutivit. Ata kanë risjellë në diskutim dënimin e Kryetarit të Komunës, duke aluduar në pamundësinë e qeverisjes transparente me një kryetar të dënuar. Anëtarët e Forumit Transparenca kanë qartësuar se insistimi i tyre për hapjen e vendimmarrjes së ekzekutivit nuk do të ndalet, ndërsa kanë kërkuar zgjidhje për problemin permanent të vonësve sa i përket kërkesave për qasje në dokumente publike. Nga Kryesuesi i Kuvendit u kërkua më shumë presion ndaj ekzekutivit në raport me transparencën, ndërsa anëtarët e Forumit Transparenca dhe përfaqësuesit e partive politike opozitare në parim u pajtuan për marrjen e një nisme në Kuvendin e Komunës, përmes së cilës ky institucion do t’i kërkonte Kryetarit të Komunës hapjen e vendimmarrjes ndaj mediave, shoqërisë civile dhe palëve të tjera.

- Çfarë trajtimi për diasporën?

Debati i katërt “Ballafaqim” është mbajtur me 22 korrik 2014, me temë: “Çfarë trajtimi për diasporën?”. Panelistë në këtë debat ishin Ilir Baldedaj, drejtor i Drejtorisë së Administratës Komunale, Ruzhdi Hoxha, koordinator i Zyrës së Gjendjes Civile në komunën e Prizrenit dhe Vesel Gashi, zyrtar i Policisë së Kosovës, ku debati u moderua nga gazetarja, Myrvete Axhami, anëtare e Forumit Transparenca.

Në fillim të debatit panelistët kanë prezantuar veprimet që janë ndërmarrë nga Komuna dhe Policia me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira administrative për mërgimtarët si dhe kushteve më të mira të sigurisë. Ata kanë pohuar se mërgimtarët sikurse edhe qytetarët tjerë shërbehen në mënyrë efikase me dokumentet e gjendjes civile. Ndërsa përfaqësuesi nga Policia e Kosovës ka theksuar se ky institucion ka hartuar planin operativ që aplikohet gjatë periudhës kur qyteti frekuentohet nga mërgimtarët, ku përfshihet siguria në trafik por edhe parandalimi i veprave të ndryshme penale.

Në anën tjetër, anëtarët e Forumit Transparenca dhe përfaqësuesit e partive politike opozitare kanë vlerësuar se institucionet nuk i kanë kushtuar kujdes të mjaftueshëm trajtimit adekuat të problemeve të mërgimtarëve, që në thelb janë edhe probleme të përditshme të qytetarëve të komunës së Prizrenit. Sipas tyre qeveria lokale nuk ka program qeverisës dhe si rrjedhojë nuk ka as strategji se si të ofroj një trajtim më të mirë për mërgimtarët. Fakti që qeveria komunale e Prizrenit nuk ka evidencë për numrin e mërgimtarëve nga kjo komunë sipas tyre dëshmon dështimin e sistemit kundruall

diasporës dhe trajtimit të shqetësimeve të tyre dhe vë në pah paaftësinë për të tërhequr investimet nga ta për mundësimin e zhvillimit ekonomik lokal.

- Miti i qytetit të kulturës

Debati i pestë “Ballafaqim” me temë: “Miti i qytetit të kulturës” është mbajtur më 12 shtator 2014, ku panelistë ishin Lulzim Kabashi, nënkryetar i komunës së Prizrenit dhe Urim Ukimeri, koordinator për kulturë në komunën e Prizrenit, derisa debati u moderua nga gazetari Refki Reshitaj, anëtar i Forumit Transparenca.

Diskutimi nxori në pah edhe një herë interesimin tejet të ulët të komunës së Prizrenit për të trajtuar kulturën si sektor prioritar të politikave lokale.

Problem i madh në kulturën e Prizrenit vazhdon të mbetet mënyra e alokimit të buxhetit komunal, ku pjesën dërmuese vazhdojnë të marrin projektet kapitale. Përkrahja që i ofrohet ngjarjeve të kulturës edhe më tutje trajtohet në kuadër të subvencioneve dhe ndahet me logjikën e ndihmën humanitare ndaj kulturës. Një nga temat që kishte vëmendje të theksuar gjatë diskutimit ishte festivalit "Zambaku i Prizreni" rreth të cilit u shpалosën mundësitë dhe sugjerimet për shpëtimin e tij nga degradimi i mëtejshëm.

- Prokurimi (jo)publik

Me 30 shtator 2014 në Prizren, Forumi Transparenca ka mbajtur debatin e gjashtë “Ballafaqim” me temë “Prokurimi (jo)publik” ku folën Isa Osmankaj, Shef i Zyrës së Prokurimit në Prizren dhe Osman Hajdari, anëtar i Komitetit për Politik dhe Financa pranë KK-së në

Prizren, ndërsa debati u moderua nga gazetari Fisnik Minci.

Debati u fokusua në çështjen e Prokurimit Publik në Komunën e Prizrenit, në veçanti mbi rrjedhën e procedurave të prokurimit publik, tenderimin e lëndëve, nivelin e profesionalizmit të komisioneve vlerësuese, respektimin e dispozitave të Ligjit të Prokurimit, koordinimin e Zyrës së Prokurimit me institucionet tjera sikurse edhe problematikën e çmimeve dhe moszbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm, pavarësisht të zyrës së prokurimit dhe zyrtarëve, mos transparencës dhe mbylljes në tërësi të komisioneve vlerësuese, mos raportimeve të rregullta, problemet në planifikimet paraprake, konstatimet e Auditorit të Përgjithshëm dhe mos respektimit të rekomandimeve të ZAP-it sikurse edhe ruajtjes së parasë publike, trendit të shpalljes së tenderëve para fushatës zgjedhore.

- Siguria dhe Masat Ndëshkimore

Debati i shtatë i ciklit “Ballafaqim”, u mbajt më 29 tetor 2014, me temë: Siguria dhe Masat Ndëshkimore. Për tu ballafaquar me anëtarët e Forumit, pjesëmarrës të debatit ishin: Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren, Hazir Berisha, zëdhënës i Policisë së Kosovës, Vesel Gashi reshter në Policinë e Kosovës dhe Nexhat Çoçaj, drejtor në DKA.

Debati trajtoi çështje të ndryshme si: sigurinë në shkolla, kamerat e sigurisë dhe monitorimi i tyre, vjedhjet, armëmbajtjet pa leje sikurse edhe politikat ndëshkimore, derisa u paraqitën edhe statistikat nga veprat penale më të shpeshta gjatë këtij viti në Komunën e Prizrenit.

Në fillim të debatit panelistët prezantuan një

rezyme të përgjithshme për sa i përket ndërmarrjes së masave institucionale karshi sigurisë në Komunën e Prizrenit. Sipas panelistëve gjendja e sigurisë është e qetë pavarësisht statistikave të veprave të identifikuara nga institucionet.

Në anën tjetër, anëtarët e Forumit Transparenca dhe përfaqësuesit nga partitë opozitare në Prizren nxorën në pah fakte të shumta që e bënë evidente sigurinë e ultë në Komunën e Prizrenit. Presioni nga politika për mbyllje të rasteve sa i përket rasteve të zyrtarëve, mos ndëshkimi i kryesve, korniza ligjore e zbehtë karshi ndëshkimit të kryesve të veprave penale, armëmbajtja nëpër shkolla, rrahja, siguria politike, korrupsioni, etj, ishin çështjet që u cekën nga diskutuesit.

- Rrënimet si dëshmi e (pa)fuqisë

Debati i tetë “Ballafaqim”, me temën “Rrënimet si dëshmi e (pa)fuqisë” është mbajtur më 18 dhjetor 2014, me panelistët Nijazi Kryeziu, Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Bedri Bytyqi, Drejtor i Inspektoratit në Komunën e Prizrenit. Debati trajtoi çështjen e rrënimeve që Komuna e Prizrenit i ka ndërmarrë kohëve të fundit të cilat kanë ngritur një numër dilemash në mesin e qytetarëve. Një nga shqetësimet më të mëdha ishte qasja selektive e komunës ndaj parregullsive urbane në qytet, duke treguar vendosmëri për zbatimin e ligjit në rastet që konsiderohen “të lehta”.

- Punësimet në arsim: Edukim apo Degradim?

Me 13 mars 2015, është mbajtur debati i nëntë “Ballafaqim” me temë: ‘Punësimet në arsim: Edukim apo Degradim?’. Diskutimi është zhvilluar rreth gjendjes aktuale në arsimin prizrenas, pasi është raportuar për një numër

rastesh të punësimeve në shkolla ku dyshohet për shkelje të kriterëve të konkurseve, pagesë joligjore për të fituar vendin e punës dhe ndikim të figurave të fuqishme të politikës.

Panelistë në këtë ballafaqim ishin Nexhat Çoçaj, Drejtor në Drejtorinë Komunale të Arsimit, Nait Hasani, Kryetar i Komisionit për Arsim në Parlamentin e Kosovës, dhe Arbër Rexha, Kryetar i Komisionit për Arsim në Komunën e Prizrenit, kurse debati u moderua nga gazetari Qazim Morina, anëtar i Forumit Transparenca.

- Parkingjet në qytetin e Prizrenit

Debati i dhjetë “Ballafaqim” është mbajtur më 27.03.2015, me temën “Parkingjet në qytetin e Prizrenit”, ku folën z. Hasan Hasani, Drejtor në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, z. Ilir Baldedaj, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe z. Avdi Kryeziu nga Policia e Kosovës nën moderimin e gazetarës Valbona Musliu, anëtare e Forumit Transparenca. Diskutimi gjatë debatit trajtoj tematikat rreth gjendjes aktuale për sa i përket parkingjeve publike, mënyrës së dhënies së tyre në shfrytëzim, dobisë që i sjellin buxhetit komunal, etj, me fokus, baza ligjore e dhënies në shfrytëzim të pronës publike për sa i përket personave, operatorëve që e ushtrojnë këtë veprimtari, parkingjet private dhe kontrollit të tyre nga institucionet përgjegjëse, gjithashtu janë shqyrtuar edhe sfidat e sigurisë në trafik si pasojë e parkimit ilegal dhe çështje të tjera.

ii) Tryeza: “Qeverisja e mirë dhe zyrtarët që kanë problem me ligjin”

Forumi Transparenca organizoi tryezën e diskutimit: “Qeverisja e mirë dhe zyrtarët që kanë problem me ligjin”, më 13 shkurt 2015 në Prizren, ku është theksuar se zyrtarët që kanë probleme me ligjin, respektivisht me organet e

drejtësisë nuk mund të ofrojnë qeverisje të mirë. Nisja e hetimeve, aktakuzat dhe proceset gjyqësore ndaj tyre luhatin besimin e publikut në ta, që për pasojë sjellë edhe degradim të mëtutjeshëm të parimeve të llogaridhënies dhe përgjegjësisë karshi qytetarëve.

Panelistë në tryezën e Forumit Transparenca ishin Fisnik Korenica, nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike dhe Valbona Musliu, gazetarë dhe anëtare e Forumit Transparenca, ndërsa ajo u moderua nga Kreshnik Basha.

Diskutimi në tryezë u fokusua në praktikën e deritanishme nëpër komunitat e Kosovës që tregojnë se zyrtarë të zgjedhur publik, si pasojë e dyshimeve të bazuara për shpërdorim të detyrës zyrtare janë përballë fillimisht me hetime, e pastaj dhe me gjykime, por që pothuajse asnjëri nuk është larguar nga pozita publike, madje as në rastet kur ka pas aktgjykime fajësuese për ta.

Si rrjedhojë ka dal konstatimi se në institucionet publike nevojitet të ketë zyrtarë me integritet që nuk e shpërdorojnë besimin e publikut.

iii) Qëndrimet publike të Forumit Transparenca

Përgjatë vitit të parë të veprimtarisë, Forumi Transparenca raportoi për publikun përmes reagimeve dhe komunikatave defektet e dikastereve të komunës.

Ramadan Muja, i vetmi Kryetar i mbyllur në Kosovë

Gjatë muajit prill të vitit, Forumi Transparenca i ka bërë thirrje kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja që t’i rihapë takimet me drejtorët komunal për media dhe shoqërinë civile. Kërkesa për hapjen e vendimmarrjes së ekzekutivit është përsëritur edhe në debatin

“Ballafaqim” mes Forumit Transparenca dhe zyrtarëve të komunës, e cila ka trajtuar çështjen e transparencës dhe llogaridhënies.

Me gjithë këtë angazhim të medias dhe shoqërisë civile në Prizren, Ramadan Muja vazhdon të mbajë të mbyllur procesin e vendimmarrjes dhe menaxhimit të parasë publike. Duke e konsideruar transparencën si parakushtin themelor të qeverisjes demokratike dhe pasi që deri më tani nuk kemi pranuar asnjë përgjigje, ne anëtarët e Forumit Transparenca ripërsërisim kërkesën tonë për anulimin e menjëhershëm të vendimit për mbylljen e takimeve të Kryetarit me drejtorët.

Kryetari i komunës së Prizrenit edhe në mandatin e tij të tretë të qeverisjes vazhdon praktikën e vendimmarrjes së mbyllur. Që nga marrja e një vendimi të këtillë vite më parë, asnjëherë nuk është dhënë një arsyetim i artikuluar dhe bindës për arsyeshmërinë e kësaj mbylljeje. Kjo praktikë, e cila bie ndesh me parimet themelore të qeverisjes transparente është dëshmia më e mirë se komuna e Prizrenit po dështon në promovimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

Muja filloi të hapet, por nuk mjafton

Pas thirrjeve të vazhdueshme të Forumit Transparenca drejtuar kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja që të hapë vendimmarrjen, para disa ditësh ai vendosi t’i hapë takimet e tij me drejtorët për mediat dhe shoqërinë civile. Për Forumin Transparenca, ky veprim paraqet një lëvizje pozitive drejt transparencës dhe llogaridhënies, por në asnjë mënyrë përmbushje të plotë të këtyre parimeve të qeverisjes demokratike. Për këtë arsye, ne i bëjmë thirrje kryetarit të komunës që këtë veprim fillestar ta pasojë me hapa të tjerë të

rëndësishëm. Hapja e takimeve ku votohet vetëm formalisht dhe merren vendimet e dakorduara paraprakisht paraqet një manifestim të zbehtë të transparencës dhe llogaridhënies.

Për të vazhduar me veprime të njëmendta drejt qeverisjes demokratike, nga kryetari i komunës kërkojmë publikimin e gjithë materialit (propozimeve) një javë para se të mbahet takimi i tij me drejtorët. Kjo do të mundësonte hapjen e vendimmarrjes dhe do t’u ofronte kohë të mjaftueshme të gjitha palëve të interesuara që të japin komente para se të merren vendimet përfundimtare. Pasi që kryetari i komunës ka krijuar praktikën e takimeve përgatitore me drejtorët (një javë para takimeve të vendimmarrjes), nga ai kërkojmë që edhe ato takime t’i hapë për mediat dhe shoqërinë civile.

Në të njëjtën kohë, duke e vlerësuar rëndësinë që ka në qeverisjen demokratike, Forumi Transparenca kërkon që mediave dhe shoqërisë civile t’u ofrohet qasje në të gjitha fazat e procesit të prokurimit publik. Ne mendojmë që komuna e Prizrenit vazhdon të jetë e mbyllur, duke e kufizuar menaxhimin e parasë publike në disa individë brenda ekzekutivit. Kjo praktikë është në kundërshtim të plotë me parimet e qeverisjes transparente dhe llogaridhënese. Për këtë arsye, Forumi Transparenca kërkon që mediave dhe shoqërisë civile, e përmes tyre edhe gjithë qytetarëve, t’u ofrohet mundësia e monitorimit të të gjitha proceseve të prokurimit publik, nga vendimet për shpalljen e thirrjeve deri në hapjen dhe vlerësimin e ofertave.

Muja refuzon ballafaqimin me Forumin Transparenca

Pas dy ftesave brenda një muaji për të marrë pjesë në debatin “Ballafaqim” me anëtarët e Forumit Transparenca, Kryetari i Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja ka dhënë edhe një dëshmi për mungesën e transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve. Ai ka refuzuar të ballafaqohet me gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile për të diskutuar mbi çështjet e qeverisjes lokale.

Refuzimi për të diskutuar me grupet e komunitetit është shkelje e parimeve themelore të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse nga Kryetari i Komunës. Për më tepër, ky barrikadim i Kryetarit të Komunës në periudhën e hartimit të buxhetit komunal për vitin 2015 paraqet edhe shkelje të obligimeve ligjore. Sipas Ligjit për Financat Publike, Kryetari është edhe Administrator Financiar i Komunës dhe obligohet të veprojë në pajtim me obligimet ligjore të konsultimit me qytetarë në raport me menaxhimin e parasë publike.

Obligim tjetër ligjor i Kryetarit të Komunës rrjedh edhe nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, sipas të cilit, përveç takimeve publike, komunat janë të obliguara t’i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës. I njëjti ligj përcakton se Kryetari përfaqëson komunën dhe vepron në emër të saj. Forumi Transparenca e ka ftuar Kryetarin e Komunës për t’u informuar dhe diskutuar mbi qeverisjen lokale, ndërsa refuzimi i tij qartë paraqet shkelje ligjore.

Kryetari Muja edhe një herë është dëshmuar si shkelës i vullnetit të qytetarëve duke refuzuar edhe debatin publik me gazetarët dhe aktivistët e shoqërisë civile. Kjo mbyllje e tij është në kundërshtim me praktikën e qeverisjes

demokratike dhe shkelje e kontratës së tij me qytetarët, të cilët përmes votës e kanë autorizuar atë që t’u shërbejë, duke qeverisur në mënyrë transparente dhe llogaridhënëse. Forumi Transparenca shpreh mospajtimin e vet me këtë veprim jodemokratik të Kryetarit Muja. Megjithatë, ne dëshirojmë t’i japim edhe një mundësi Kryetarit, duke e ftuar edhe një herë publikisht që të ballafaqohet me Forumin Transparenca. Kjo është ftesa e fundit që Forumi Transparenca i bën Kryetarit Muja që të përmbushë njërin nga obligimet më bazike ligjore dhe demokratike, takimin dhe komunikimin me qytetarët.

Kryetari Muja tani duhet të suspendoj edhe drejtorin e Arsimit

Më datën 11 dhjetor 2014, Prokuroria Themelore e Prizrenit ka parashtruar në Gjykatën Themelore aktakuzën ndaj drejtorit të Arsimit në Komunën e Prizrenit, Nexhat Çoçaj, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se nga viti 2008 deri në vitin 2012 gjatë organizimit të manifestimit “Java e Remzi Ademaj” ka dëmtuar buxhetin e Komunës së Prizrenit dhe se në këtë mënyrë ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, personalisht dhe në bashkëpunim me dy mësimdhënës tjerë.

Që prej kësaj date kanë kaluar më shumë se një javë dhe kryetari i Komunës së Prizrenit nuk e ka ndër marrë asnjë veprim disiplinor ndaj këshilltarit të tij, të cilit madje në këtë periudhë i ka dhënë rastin që të prezantoj raportin e punës njëvjeçare të Drejtorisë së Arsimit në tubimin publik me qytetarët e komunës së Prizrenit.

Përkujtojmë se në korrik të këtij viti, kryetari i Komunës pati suspenduar drejtorin e Financave,

Mehmet Bytyç, që në fazën e zhvillimit të hetimeve, pas vendimit të Gjykatës Themelore që atij t'i caktohet masa e arrestit shtëpiak. Në këtë vendim të Mujës thuhet se Bytyç suspendohet deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Ndonëse natyra e veprave penale për të cilat akuzohen këta dy drejtorë dallojnë, megjithatë e përbashkëta është se besimi i publikut në këta zyrtarë politik është luhatur.

Për më shumë akuzat e Prokurorisë që rëndojnë mbi drejtorin Çoçaj janë të rënda, pasi që ekziston dyshimi i bazuar mirë se janë bërë shpenzime jashtë destinimit për të cilën ishin ndarë mjetet dhe në këtë mënyrë është dëmtuar buxheti i komunës.

Prandaj thirrja e Forumit Transparenca është që kryetari Muja ashtu sikurse në rastin Bytyç, të suspendoj edhe drejtorin e Arsimit, Nexhat Çoçaj, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës, në mënyrë që organeve të drejtësisë t'i hapet rruga për gjykim të drejtë dhe të pavarur.

Gjithashtu konsiderojmë se tani e tutje duhet të aplikohen në mënyrë strikte parimet e qeverisjes së mirë, në mënyrë që secili zyrtar politik që është nën hetime apo ka aktakuzë të ngritur të mos e ushtroj postin publik, deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës.

Natyrisht se kjo thirrje e Forumit Transparenca vlen edhe për vet kryetarin e Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, i cili në mars të këtij viti është dënuar nga Gjykata Themelore për shpërdorimin e detyrës apo autoritetit zyrtar, në katër raste të ndryshme.

Forum Transparenca është themeluar në mars të këtij viti, si përpjekje e koordinuar e akterëve të shoqërisë civile dhe mediave në Prizren, të cilët kanë për synim rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies së qeverisë lokale të Prizrenit. Ky trup joformal përbëhet nga aktivistë të shoqërisë civile dhe gazetarë të Prizrenit, të cilët janë aktiv në fushën e qeverisjes demokratike.

Të hetohen rastet e punësimeve të parregullta në shkollat e Prizrenit

Forum Transparenca po i përcjellë me shqetësim zhvillimet e fundit që lidhen me rastet e dyshuara të punësimeve jo të rregullta në shkollat e komunës së Prizrenit. Ditëve të fundit është raportuar për një numër rastesh të punësimeve në shkolla ku dyshohet për shkelje të kriterëve të konkurseve, pagesë joligjore për të fituar vendin e punës dhe ndikim të figurave të fuqishme të politikës. Këto dyshime janë edhe një tregues i degradimit të sektorit të arsimit në Prizren përgjatë gjithë periudhës së pasluftës.

Të gjitha këto raste të dyshimeve janë arsye mëse e mjaftueshme që institucionet përkatëse të ndërmarrin veprime të menjëhershme në pajtim me ligjin. Prandaj, Forum Transparenca u bën thirrje qeverisë lokale të Prizrenit dhe qeverisë qendrore të Kosovës (në rradhë të parë Ministrisë së Arsimit) që t'i hulumtojnë këto raste dhe së shpejti të njoftojnë opinionin publik me të gjetuar mbi gjendjen në shkollat e Prizrenit. Në të njëjtën kohë, për shkak të dyshimeve serioze të ngritura ditëve të fundit, i bëjmë thirrje edhe institucioneve të drejtësisë që t'i nisin hetimet në pajtim me autorizimet që i kanë.

Edhe gjatë vitit të kaluar Forumi Transparenca ka trajtuar çështje problematike të sektorit të arsimit në Prizren, për të cilat është bërë thirrje për veprim institucional. Në mungesë të këtyre veprimeve, ditëve të fundit kemi përfunduar me një numër të konsiderueshëm rastesh të raportuara nga vetë qytetarët dhe të publikuara në mediat lokale dhe qendrore. Mungesa e veprimit të menjëhershëm institucional për t'i hetuar këto raste do të paraqiste përpjekje për heshtjen e këtyre rasteve dhe do t'i dekurajonte të gjithë ata që kanë marrë guximin t'i sfidojnë parregullsitë në këtë sektor.

Forum Transparenca i bën thirrje të gjithë qytetarëve që t'i raportojnë rastet e tyre të dyshimeve mbi punësimet jo të rregullta në shkollat e Prizrenit. Vetëm përmes mobilizim të përgjithshëm shoqëror mund të ndalohet degradimi i mëtejshëm i sektorit të arsimit në Prizren.

Strategjia komunale për informim është hartuar me qasje përjashtuese

Komuna e Prizrenit ka iniciuar hartimin e Strategjisë Komunale për Informim, Komunikim dhe Pjesëmarrje qytetare. Në versionin para-final, të shpërndarë nga Zyra për Informim e Komunës së Prizrenit, në pjesën ku përshkruhet metodologjia në faqen 15 thuhet se “strategjia është hartuar me një pjesëmarrje të gjerë, duke përfshirë përfaqësues të organeve komunale relevante, organizatave të shoqërisë civile dhe të medieve”.

Ndërsa në faqen 14 sqarohet se “fillimisht është organizuar një punëtori me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes, ku janë identifikuar fushat problemore që duhen adresuar me strategji. Gjithashtu, është bërë një analizë gjithëpërfshirëse e problemeve sipas

fushave problemore”. Tutje shkruan se “për hartimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për komunën e Prizrenit është formuar një grup i punës, i përbërë nga përfaqësues të komunës, nga OSHC-të, OJQ-të dhe ekspertë të fushave përkatëse, si dhe organeve gjegjëse komunale, siç është ZIP, zyra ligjore dhe zyra për integritet evropiane”. Përveç kësaj, thuhet se janë “konsultuar edhe përfaqësues të zyrave për informim nga komunat tjera...”.

Po ashtu theksohet se “tryezat dhe punëtoritë gjatë fazës përgatitore me sukses i kanë shërbyer synimit për përfshirjen e sa më shumë palëve nga qeverisja lokale dhe komuniteti i OJQ-ve” dhe se kjo qasje “ofron garanci që strategjia do të zbatohet me sukses dhe do të ketë përkrahjen e shoqërisë së gjerë”. Në këtë draft potencohet se “metodologjia e përdorur në procesin e hartimit të strategjisë dhe të planit të veprimit është përmes planifikimit me pjesëmarrje të gjerë, gjegjësisht përmes metodologjisë së kornizës logjike dhe veglave të saja të planifikimit”.

Forum Transparenca përmes kësaj letre publike dëshiron që ta njoftojë opinionin se pjesa dërrmuese e anëtarëve të saj, e veçanërisht komuniteti i gazetarëve nuk janë përfshirë fare në procesin e konsultimeve për hartimin e kësaj strategjie.

Për këtë shkak Forum Transparenca konsideron se Strategjia komunale për informim, komunikim dhe pjesëmarrje qytetare e Komunës së Prizrenit është hartuar me një qasje përjashtuese, sidomos ndaj komunitetit të gazetarëve, por edhe aktivistëve të shoqërisë civile që kanë përvojë disavjeçare në monitorimin e punës së organeve komunale, si dhe grupeve të qytetarëve, të cilat në këtë rast janë palë tejet të rëndësishme të interesit sa i

përket informimit, komunikimit dhe pjesëmarrjes qytetare.

Forumi Transparenca dëshiron të sjellë në vëmendje se vendimi i kryetarit të komunës për lejimin e hartimit të strategjisë është marrë më 3 shkurt, derisa drafti i parë është prezantuar para gazetarëve dhe monitoruesve nga shoqëria civile vetëm pas tre javësh, më 25 shkurt, dhe atë në një konferencë për shtyp. Pas vërejtjeve të paraqitura, kanë pasuar ftesat për OJQ-të për një punëtori e një tryezë, por jo edhe për gazetarët.

Forumi Transparenca vlerëson se gazetarët e Prizrenit nuk e kanë merituar një injorim të tillë në hartimin e këtij dokumenti strategjik dhe se është dashur të jenë të përfshirë nga fillimi në procesin e hartimit të këtij dokumenti strategjik, njëjtë sikurse edhe aktivistët e shoqërisë civile që kanë përvojë shumëvjeçare në monitorimin e punës së organeve komunale. Me këtë rast Forumi Transparenca shpreh dyshimet e bazuara të anëtarëve të saj se hartimi i strategjisë nuk është realizuar me pjesëmarrje të gjerë dhe se si i tillë është ndërtuar bazuar në vlerësimet e ngushta, pa i përfshirë nevojat e të gjitha palëve të interesit.

VI. Ndikimi i projektit

Angazhimi i Forumit Transparenca përgjatë kësaj periudhe kohore ka prodhuar ndikim pozitiv në disa drejtime.

E para, insistimi i anëtarëve të Forumit Transparenca ka bërë që qeveria komunale të hap mbledhjet e saja, duke mundësuar përcjelljen e takimeve dhe marrjen e informatave mbi vendimet e miratuara nga ekzekutivi komunal.

Po ashtu pas debatit “Ballafaqim” në lidhje me punësimet në arsim, zyrtarët e lartë komunal që mbanin nga dy pozita, një në ekzekutiv e tjetrën në arsim, me kërkesë të kryetarit, kanë liruar pozitat e tyre në arsim.

Ndërkaq debati rreth gjendjes në kulturë, ka nxitur veprimet për sa i përket ndalimit të degradimit të plotë të festivalit “Zambaku i Prizrenit”, pasi që pjesëmarrësit në debat kanë kërkuar që të merren masa dhe tanimë “Zambaku...” për edicionin e vitit 2015 do të udhëhiqet nga themeluesit e vet, SHKA “Agimi”, Shoqata e Kompozitorëve të Kosovës, RTK dhe RrOK-u.

Gjithashtu një praktikë që nuk ka ekzistuar më parë ka nisë të zbatohet pas takimeve të kryetarit Muja me drejtorët, me ç’rast mbahen konferenca të rregullta shtypi, derisa ofrohen me kohë edhe të gjitha propozimet në lidhje me vendimet që do të aprovohen nga ekzekutivi komunal.

Gjatë 12 muajve të kaluar Forumi Transparenca ka mbajtur 10 debate “Ballafaqim”, ka publikuar 5 komunikata për shtyp, 2 reagime publike, 1 njoftim për medie dhe ka organizuar 1 Tryezë diskutimi.

Këto aktivitete janë mbuluar nga mediet (lokale dhe nacionale) sipas të dhënave në vijim: 50 kronika televizive me rreth 130 min paraqitje; gjithsejtë 25 artikuj gazetaresk me rreth 12 faqe, afër 90 raportime në ueb portale dhe rreth 75 minuta raportim në radio.

XI. Falënderim

Forumi Transparenca është thellësisht mirënjohëse ndaj Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, që ka vlerësuar këtë komponent të projektit të transparencës dhe ka vendosur ta mbështesë.